

Gruaja në Islam

## Gruaja Dhe Parajsa në Islam

Imran Hosein [www.imranhosein.com](http://www.imranhosein.com)

Revolucion laik feminist u gritë mbi botën nga Perëndimi me një agjendë të pafe në thelb, për të çliruar gratë nga "zinxhirët" e epokave duke transformuar plotësisht statusin, rolin dhe funksionin e sajë në shoqëri. Duke e bërë këtë, e ka kthyer rregullin e mëparshme fetar dhe të shenjtë, me kokë poshtë në mënyrë të tillë sa që duket se Dielli tani po lind nga perëndimi.

Laicizmi çoj në materializëm i cili nga ana tjetër ia mohoi gruas çdo realitet tjetër përtej realitetit të saj material. Si pasojë, gruaja e re dhe e bukur bë perëndeshë e kohës. Por ajo ishte një perëndeshë që ishte shfrytëzuar paturpësisht në reklama, për të shitur çdo gjë. Ajo u bë një gjë për tu shijuar, shfrytëzuar, abuzuar degraduar the për tu hedhur, kurë bukuria dhe joshja e saj seksuale fillojnë të veniten. Atëherë një turmë vajzash shkollore vrapojnë për ta zëvendësuar atë. Edhe kalisopiani (lloj këngëtari), e dha pikëpamjen e tij lidhur me këtë temë para disa kohësh kur i këndoj prostitutës "...dhe kur i gjen ato të bankrotuara (i.e vështërsi financiare) mund ti marrësh të gjitha ato për asgjë."

Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) profetizoi mashtrimin i cili do i skllavëroj gratë. Ai tha se, "gratë do të jetë të veshur megjithatë prapë do të jenë të zhveshura", duke parashikuar një kohë kur do të shtohet lakuriqësia e femrës që do të jetë e lidhur tërësisht me revolucionin feminist. Udhëheqësit e Karnavalit në Trinidad tani janë duke u ankuar se nuk mund të përdorin rroba të mjaftueshme për të bërë dizajne kreative pasi që gratë përherë e më shumë kërkojnë që kostumet të jenë me sa më pakë pëlhurë. 'Trupi Lakuriq' i femrës është përdorur për të nxitur një revolucion seksual i cili do ta arrij kulmin, sipas Profetit se "shumica e fëmijëve do të lindin jashtë martesës" dhe "njerëzit do të bëjnë marrëdhënie seksuale në publik si gomarët". Kur ne shohim seksin publikisht të simuluar në karnavalin Trinidad ne e dimë se revolucioni feminist së shpejti do të arrij kulmin me gruan të shndërruar në një gomaricë. Pavarësisht nga ky dështim kolosal, bota moderne e pafe, ka insistuar mbi hapjen e një betejë 'gjinore' në kërkimin e "barazisë" derisa bëjnë luftë kundër Islamit. Objektivi i fundit është Hijabi (mbulesa) e pafajshme që është sulmuar në mënyrë djallëzore për shkak se ajo e pengon rrugën për gruan myslimane të tretet në tenxhere shkrirëse të pafe.

Islami kurrë nuk ka kërkuar për të vënë një simbol të barazisë gjinore. 'Gruaja' kurrë nuk mund të studiohen as të kuptohet në një kontekst të pavarur nga "burri". Të dy këta janë të pandashëm. Profetit deklaroi se gratë janë "... gjysma e dytë binjake e burrave." Kurani konfirmoi këtë ndër-varësi kur deklaroi se "Ato janë prehje për ju, dhe ju jeni prehje për ato." Dhe në një pasazh me një bukuri letrare madhështore Kurani (el-Lail, 92:1-4) e ka drejtuar vëmendjen së pari te 'nata' dhe atë që ajo e mbështjell dhe e fsheh me mister dhe bukuri, dhe pastaj iu kthye 'ditës' me ndriçimin e vetë që ekspozon çdo gjë dhe nuk le asgjë të fshehur, dhe pastaj vazhdoi të shpjegojë se "mashkull 'dhe' femra 'luajnë funksionin e ngjashëm me' ditën 'dhe' natën ". Në të njëjtën mënyrë që 'dita' dhe 'nata'

kanë funksione të ndryshme, por megjithatë prapë janë të ndërvarura, ashtu janë edhe 'mashkulli' dhe 'femra'.

Kur kjo filozofi e gjinisë ishte aplikuar për shoqërinë Myslimane 'nata' kurrë nuk u përpoq që të bëhet 'ditë'. Por edhe më tepër 'dita' dhe 'nata' përjetësisht kanë lënguar për njëri-tjetrin. Kështu që ne kurrë nuk iu nënshtruan fenomenit të neveritshëm (të cilin qytetërimi evropian tani po e eksportuar në pjesën tjetër të botës), të 'shndërrimit' të ditës në 'natë' dhe anasjelltas. Gratë në një shoqëri të tillë, jo vetëm që i kanë përmbushen të gjitha funksionet e tyre të shenjta si gra dhe si nëna, duke dhënë kështu një kontribut të dukshëm në ruajtjen e shëndetit, forcës dhe stabilitetit të familjes, por, përveç kësaj, ato e kanë ruajtur edhe aspektin e tyre femërorë dhe pjellorinë e tyre. Dhe kështu gruaja myslimane ka mbetur me të vërtetë një grua dhe atë në aspektin mahnitës! Një kohë që ka prodhuar një prift të pamartuar ka këmbëngulur në atë se, një njeri duhet të largohet nga gruaja në mënyrë që ti kthehet Zotit. Profeti Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut, Më Të Lartit qoftë mbi të) u përgjigj duke u shprehur se "Tre gjëra janë bërë të dashur për mua në këtë botën tuaj – aroma e mirë, gruaja dhe lutja." Dhe kështu Islami kundërshtoi beqarin dhe 'objektin' duke e njohur gruan si edhe lutjen, të jetë një mënyrë përmes të cilës një njeri mund udhëtoj për në parajsë.

Përktheu

Kastriot Gashi 